



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1293/ 15 prot.

Datë 14.09.2022

**V E N D I M**

**Nr. 887/2022**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.09.2022 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-26060-04-21-2022, me objekt “Blerje kancelari për nevojat OSHEE Group Sh.A, për një vit”, me fond limit 59,423,158.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23.05.2022 nga autoriteti kontraktor Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group Sh.A

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK  
*Autostrada Tiranë-Durrës, Rruga Dytësore Km 9, Godine 3 katëshe, Kashar, Tiranë.*

**Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a  
*Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr. 88, H.1, Njësia Administrative Nr.7, 1023, Tiranë*

**Subjekti i Interesuar:** Operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK  
*Autostrada Tiranë-Durrës, KM 8, Kashar, Tiranë*

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V ë r e n:****I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.5. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II***Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 22.04.2022 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-26060-04-21-2022, me objekt “Blerje kancelari për nevojat OSHEE Group Sh.A, për një vit”, me fond limit 59,423,158.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23.05.2022 nga autoriteti kontraktor Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group Sh.A.

II.2. Në datën 23.05.2022 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.3. Në datën 03.06.2022 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave ku rezultojnë si vijon:

1. “Infosoft Office” SHPK	47,374,239.64	lekë	kualifikuar
2. “Librari Dyrrahu” SHPK	47,747,725	lekë	skualifikuar
3. “Marketing & Distribution” SHPK	57,454,392	lekë	skualifikuar
4. “Interlogistic” SHPK	59,032,679.90	lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 08.06.2022 është kryer publikimi i njoftimit të fituesit të procedurës së prokurimit në SPE dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 76, datë 13.06.2022.

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 16.06.2022 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1293 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2022/2286 e operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 1293/2 prot., datë 17.06.2022, duke u pasqyruar kriteret të cilat operatori ekonomik ankimues “Interlogistic” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK.

II.7. Me shkresën nr. 6022/4 prot, datë 23.06.2022 me objekt: “Dërgim dokumentacioni”, drejtuar KPP-së, protokolluar me tonën me nr. 1293/3 prot., datë 27.06.2022, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Interlogistic” SHPK dhe ka vendosur mospranimin e ankesës.

II.8. Me shkresën nr. 1293/4 prot., datë 04.07.2022, KPP i është drejtuar autoritetit kontraktor Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group Sh.A dhe për dijeni operatorëve ekonomikë “Interlogistic” SHPK dhe “Infosoft Office” SHPK, duke i kërkuar të dorëzojë pranë KPP mostrat e paraqitura për këtë procedurë prokurimi nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, si dhe dokumentacionin shoqërues të tyre, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e shkresës.

II.9. Me shkresën nr. 6653/1 prot., datë 06.07.2022 me objekt “*Mbi dorëzimin e mostrës dhe dokumentacionit të kërkuar*” drejtuar KPP-së, autoriteti kontraktor dorëzoi informacionin e kërkuar. Gjithashtu, bashkëlidhur shkresës së mësipërme, autoriteti kontraktor ka dorëzuar mostrën Letër A4 1 (një) rizëm e paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

II.10. Për shkak të specifikës së kësaj procedure prokurimi, KPP konstaton, se për sqarimin e fakteve dhe pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, të papranuara nga autoriteti kontraktor konkretisht në lidhje me specifikimet teknike të mostrës, kërkohen njohuri të posaçme teknike nga laboratorë të specializuar për kryerjen e testimit të letrës A4. Prandaj KPP për një gjykim të drejtë dhe transparent të ankesës, vlerësoi të kryhej veprimi procedural i testimit të mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK në përputhje me specifikimet teknike, referuar pretendimeve të ngritura nga operatori ekonomik ankimues “Interlogistic” SHPK, me qëllim asistimin e Komisionit të Prokurimit Publik, për gjykimin sa më të drejtë të ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.11. Në përgjigje të shkresës së Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 641/11 prot., datë 04.05.2022, me objekt: “*Kërkesë për informacion*”, me shkresën nr. 185/1 prot., datë 09.05.2022 Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit informon se: “[...] laboratori i vetëm i akredituar prej saj për testimin e letrës dhe kartonit është Eko-Studio Projekt SHPK me adresë: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Nr.48, Tiranë”

II.12. Me shkresën nr. 1293/6 prot., datë 15.07.2022 me objekt “*Kërkesë*” Komisioni i Prokurimit Publik kërkoi informacion nga laboratori testues “Eko-Studio-Projekt” SHPK si më poshtë vijon:

*“Komisioni i Prokurimit Publik po shqyrton një ankesë për një procedurë prokurimi për të cilën i shfaqet nevoja për kryerjen e një hetimi administrativ në lidhje me pretendimet e ngritura.*

*Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime lidhur me përmbushjen e kërkesave të autoritetit kontraktor për sa i përket specifikimeve teknike për letren A<sub>4</sub> dhe për këtë kërkohet testimi i mostrës së letrës A<sub>4</sub> (Double A ose ekuivalente) sipas parametrave të kërkuar në DST:*

- 1. Pesha e testuar sipas ISO 534 – format A<sub>4</sub> jo më pak se 78 gr/m<sup>2</sup> paketuar në rizma 500 fletë. 1 risëm me peshë jo më të vogël 2500 gr në peshore elektronike*
- 2. Bardhësia CIE e testuar sipas ISO 11475- jo më pak se 148*
- 3. Opaciteti i testuar sipas ISO 2471 - > 92%*
- 4. Ndriçimi i testuar sipas ISO 2470- jo më pak se 101*

*Sqarojmë se, në përgjigje të shkresës së Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 641/11 prot., datë 04.05.2022, me objekt: “Kërkesë për informacion”, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit me shkresën nr. 185/1 prot., datë 09.05.2022 informon se: “[...] laboratori i vetëm i akredituar prej saj për testimin e letrës dhe kartonit është Eko-Studio Projekt SHPK me adresë: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Nr.48, Tiranë”.*

*Sa më sipër, në zbatim të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, si edhe të Vendimit Nr.867 datë 10.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e*

*administratës shtetërore”, kërkojmë informacion nëse kompania juaj është e profilizuar ose jo për të kryer vlerësimin teknik të parametrave të kërkuar më sipër për letrën A<sub>4</sub>, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit. Gjithashtu kërkojmë nga ana juaj të na informoni mbi koston apo tarifën, të cilat do të mbulohen nga ankimuesi. ”*

II.13. Me shkresën nr. 1293/7 prot., datë 15.07.2022 me objekt “Vënie në dijeni”, KPP i është drejtuar autoritetit kontraktor dhe për dijeni operatorëve ekonomikë “ Interlogistic” SHPK dhe “Infosoft Office” SHPK duke i njoftuar, se për shkaqe të nevojshme për verifikim në përputhje me nenin 115 pika 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” nuk është e mundur dalja me një vendim përfundimtar brenda afatit të parashikuar në ligjin e prokurimit publik.

II.14. Me shkresën e datës 18.07.2022 protokolluar në KPP me nr. 1293/8 prot., datë 21.07.2022 me objekt “Kthim-përgjigje” drejtuar KPP-së dhe për dijeni autoritetit kontraktor dhe “Eko-Studio-Projekt” SHPK, operatori ekonomik ankimues “Interlogistic” SHPK shfaq pretendime në lidhje me testimin e mostrave nga laboratorit testues “Eko-Studio-Projekt” SHPK.

II.15. Me shkresën nr. 567 prot., datë 25.07.2022, protokolluar me tonën me nr. 1293/9, datë 27.07.2022 me objekt “Kthim-përgjigje shkresës me nr. 1293/6 prot., datë 15.06.2022”, “Eko-Studio-Projekt” SHPK, informon Komisionin e Prokurimit Publik si më poshtë vijon:

*“[...] Eko Studio Projekt SHPK ka në përbërje Laborator të Akredituar dhe të kompletuar me instrumente të standardeve bashkëkohore dhe efikase dhe kryen testim permanent dhe me kampione të komponentëve të [...] letrës dhe kartonit.”*

*Për kryerjen e matjeve laboratorike Eko-Studio-Projekt është e pajisur me Certifikatë Akreditimi me numër Regjistrimi LT 070, konform Standartit S SH ISO/IEC 17025:2017, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, në përputhje me ligjin Nr. 116/2014 “Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë”.*

Më pas në shkresë vijohet me tabelën me standardet e provës dhe të trajtimit të mostrës dhe me sqarimin se:

*“Kryejmë edhe testim dhe matje të komponentëve të letrës dhe kartonit sipas standardeve të përcaktuara në vijim” [...].”*

Së fundi, shoqëria “Eko-Studio Projekt” SHPK shprehet se:

*“Për kryerjen e testeve dhe fiksimit të rezultateve duhet të dërgohen në ambientet e laboratorit kampione përfaqësues në mjediset e laboratorit.*

*Oferta ekonomike është si vijon:*

Nr.	Shërbim	Njësia	Sasia	Çmimi në lek pa TVSH
1.	Analiza gramaturës	Copë/një testim	1	5700
2.	Përcaktimi i bardhësisë	Copë/një testim	1	5500
3.	Përcaktimi i Opacitetit	Copë/një testim	1	6300
4.	Analiza e shkelqimit	Copë/një testim	1	7200

*v.o Në cmimet e mësipërme është përfshirë përgatitja e kampionit sipas standardeve të mostrimit si dhe kryerja e testimit dhe nxjerrja e rezultatit.”*

II.16. Për testimin e mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, me Vendimin nr. 757/2022, datë 08.08.2022 Komisioni i Prokurimit Publik vendosi si më poshtë vijon:

1. *Të urdhërojnë kryerjen e ekspertizës për analizimin e gramaturës së mostrës të paraqitur nga operatori ekonomik, “Infosoft Office” SHPK sipas metodës/standardit të kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit nga laboratorin e akredituar i shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, nëse mostra e paraqitur është në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK Procedurë e Hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-26060-04-21-2022, me objekt “Blerje kancelari për nevojat OSHEE Group Sh.A, për një vit”, me fond limit 59,423,158.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23.05.2022 nga autoriteti kontraktor Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a.*
2. *Operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK, të parapaguajë për llogari të shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, shumën prej 5,700 lekë pa TVSh si tarifë e përcaktuar me anë të shkresës nr. 567 prot., datë 25.07.2022 për testimin e mostrave dhe të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, së bashku me kopje të faturës financiare të parapagimit, brenda datës 11.08.2022 ora 11:00.*
3. *Në datën 11.08.2022 ora 11:00, të paraqiten pranë Komisionit të Prokurimit Publik përfaqësues të autoritetit kontraktor Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a dhe përfaqësues të operatorëve ekonomikë “Infosoft Office” SHPK, dhe “Interlogistic” SHPK me autorizim të posaçëm, të cilët në prani të Komisionit të Prokurimit Publik do të dorëzojnë mostrat për testim në laboratorin e akredituar pranë shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK.*
4. *Të njoftojë laboratorin e shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK për kryerjen e testimit të mostrave në datën dhe orën e përcaktuar.*
5. *Afati për kthimin e përgjigjes së testimit brenda 10 (dhjetë) ditëve punë, nga dita e nesërme e marrjes në dorëzim të mostrave.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

II.17. Në datën 11.08.2022, në ambientet e Komisionit të Prokurimit Publik u mbajt seancë dëgjimore me përfaqësues të shoqërisë “Interlogistic” SHPK, të shoqërisë “Infosoft Office” SHPK, të autoritetit kontraktor dhe KPP-së. Në prani të palëve të sipërcituara, në përgjigje të kërkesës së Komisionit të Prokurimit Publik për përzgjedhjen e mostrës që do t’i nënshtrohet testimit, nga ana e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK u deklarua që të dërgohet për testim e gjithë riza e dorëzuar si mostër dhe vetë laboratorin “Eko-Studio Projekt” të përzgjedhë fletën që do të analizojë/testojë. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua palëve prezente nëse kanë interes për të shoqëruar përfaqësuesin e KPP gjatë momentit të dorëzimit të mostrës në laboratorin e shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK. Nga palët prezente, interes shfaqti vetëm përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankimues “Interlogistic” SHPK.

II.18. Me anë të shkresës nr.618 prot., datë 18.08.2022, protokolluar me tonën me nr.1293/12 prot., datë 22.08.2022, “Eko – Studio – Projekt” SHPK ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik “Raport Testimi” të mostrave, nr. 618 Prot. datë 18.08.2022. Konkretisht, ndër të tjera në raportin e mësipërm theksohet:

*[...] Përshkrimi: Analiza e letrës me kod SPS-PS-618 i cili u mor nga njëra prej letrave të rizmës të sjella për kampionim. Përzgjedhja u krye nga vetë anëtarët e komisionit. Nga kampioni u analizua një pjesë me sipërfaqes 15 x 15 cm, e cila u peshua nga 5 herë në mënyrë të pavarur në të njëjtat kushte atmosferike. Rezultati i paraqitur më sipër është mesatarja e të gjitha peshimeve ..... Bazuar në formulën e sipërpërmendur masa mesatare e letrës është 75.903 g/m<sup>2</sup>.*

II.19. Me shkresën nr. 1293/13 prot., datë 01.09.2022 me objekt “Kërkesë për plotësimin e raportit të testimit nr. 618 prot., datë 18.08.2022” KPP i është drejtuar Eko-Studio-Projekt me kërkesën për plotësimin e raportit të testimit ku kjo e fundit të shprehej jo vetëm për peshën e një fije letër A4, por edhe për peshën e rizmës sipas pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues.

II.20. Me anë të shkresës nr.647 prot., datë 07.09.2022, protokolluar me tonën me nr.1293/14 prot., datë 09.09.2022, “Eko – Studio – Projekt” SHPK ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik “Raport Testimi” të mostrave të plotësuar, nr. 618/1 Prot. datë 07.09.2022 ku përcaktohet se sasia e mostrës është *1 rizëm*. Konkretisht, ndër të tjera në raportin e mësipërm theksohet:

*“Mostra I është e tipit letër A4 e cila u nda në nënkampion përfaqësues me përmasa: gjatësi 15 cm dhe gjerësi 15 cm. Sipërfaqja totale e letrës së peshuar është 225 cm. Pesha mesatare e letrës për sipërfaqen e peshuar është 1.70781g.....Bazuar në formulën e sipërpërmendur masa mesatare e letrës është 75.903 g/m<sup>2</sup>.*

*Mostra II u peshuan 499 fletë të rizmës të hequr nga paketimi mbështjellës të cilat kanë një peshë totale prej 2377.81 g ose 2.37781 kg.*

*Mostra III u peshua vetëm paketimi mbështjellës i rizmes i cili ka një peshë totale prej 23.16 g ose 0.02316 kg.*

*Motra IV u llogarit pesha totale e letrës së përzgjedhur nga vetë anëtarët e komisionit nga rizma Mostra IV u llogarit pesha totale e letres se perzgjedhur, nga vete anetaret e komisioni, nga rizma e sjelle pran laboratorit me siperfaqen totale te saj prej : gjatesise 29.8 dhe gjeresi 21.1.*

*(Ju sqarojme se percaktimi total i mases se letres me ane te peshimit direkt eshte e pamundur duke qene se eshte bere prerja e saj per te percaktuar gramaturen per 1 m”, per kete arsye eshte kryer llogaritja e mases me formulen e rregullit te treshit duke ditur siperfaqen totale te letres dhe peshen e nje siperfaqe specifike te saj). Nga kjo llogaritje rezulton se pesha totale e kesaj flete eshte 4.77261 g.*

*Per sa eshte thene me siper rezulton se vlera totale e nje rizme me 500 flete pa paketimin mbështjellës është shuma e Mostres II dhe Mostra IV qe ne total rezulton 2382,58 g ose 2,38258 kg ndersa vlera totale e rizmes bashke me paketimin mbeshtjelles eshte 2405.74 g ose 2.40574 kg.”*

II.21. Nga verifikimet e kryera, rezulton se nuk janë paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik argumente nga subjekte të interesuara lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori

ekonomik ankimues, sipas parashikimeve të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, “Interlogistic” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, për mospërmbushjen e kriterit “2.4.5. Me qëllim për të krahasuar përputhshmërinë me specifikimet teknike të kërkuara, në datën e hapjes së ofertave operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë mostra për letër A4 një rizem. Mosdorezimi i mostres se kerkuar perben shkak per skualifikim.” me pretendimin se operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK “ nuk përmbush kërkesat e autoritetit kontraktor, për sa i përket specifikimeve teknike për letrën A4 dhe për këtë kërkohet testimi i mostrës së letrës A4 (Double A ose ekuivalente) sipas parametrave të kërkuar në DST...”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.4 “Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim” pika 2.4.5, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

*2.4.4 Me qëllim për të krahasuar përputhshmërinë me specifikimet teknike të kërkuara, në datën e hapjes së ofertave operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë mostra për letër A4 një rizem . Mosdorezimi i mostres se kerkuar perben shkak per skualifikim.*

III.1.2. Në shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike” të modifikuar përmes shtojcës “njoftim për ndryshimin e dokumenteve të tenderit” të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

Specifikisht për letrën kërkohet :

*Format A4, jo me pak se 78 gr/m2 sipas ISO 534, paketuar ne rizma 500 flete.1 risem me peshe jo me te vogel 2500 gr ne peshore elektronike, Bardhesia CIE sipas ISO 11475 **jo me pak se 148**, me opacitet >92% sipas ISO 2471, ndricimi jo me pak se 101 sipas ISO 2470. (Double A ose Ekuivalent).*

*Leter A3, jo me pak se 78 gr/m2 sipas ISO 534 paketuar ne rizma 500 flete, Bardhesia CIE sipas ISO 11475 **jo me pak se 148**, me opacitet >92% sipas ISO 2471, ndricimi jo me pak se 101 sipas ISO 2470. (Double A ose Ekuivalent).*

*Leter A0, jo me pak se 78 gr/m2 sipas ISO 534, paketuar ne rulon, Bardhesia CIE sipas ISO 11475 **jo me pak se 148**, me opacitet >92% sipas ISO 2471, ndricimi jo me pak se 101 sipas ISO 2470. (Double A ose Ekuivalent).*



III.1.3. Nga verifikimet e kryera për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- *Mostrën e dorëzuar (së bashku me dokumentacionin shoqërues)*

III.1.4. Në nenin 77 pika 1 dhe pika 4 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

[...]

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

III.1.5. Në nenin 40 pika 6 germa a) “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

*a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;*

III.1.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.1.7. Referuar kritereve të veçanta të kualifikimit rezulton, se është kërkuar shprehimisht se me qëllim për të krahasuar përputhshmërinë me specifikimet teknike të kërkuara, në datën e hapjes së ofertave operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë mostra për letër A4 një rizem. Mosdorëzimi i mostrës së kërkuar përbën shkak për skualifikim.

III.1.8. Referuar dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor, konkretisht nga shqyrtimi i mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik *“Infosoft Office”* SHPK, KPP konstatoi se ky i fundit ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor 1 rizem mostrën Letër A4.

III.1.9. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, argumentet e operatorit ekonomik të interesuar, dokumentacionit të autoritetit kontraktor, me qëllim shqyrtimin e drejtë të pretendimeve të ankimuesit dhe argumenteve të sjella nga operatori ekonomik i interesuar, në mbështetje të pikës 5 të nenit 115 të LPP, KPP gjykoi të domosdoshme kryerjen e testimit të mostrave të paraqitura nga operatori ekonomik *“Infosoft Office”* SHPK, me qëllim verifikimin e përmbushjes së specifikimeve teknike të mostrës së dorëzuar. Në përgjigje të shkresës së Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 641/11 prot., datë 04.05.2022, me objekt: *“Kërkesë për informacion”*, me shkresën nr. 185/1 prot., datë 09.05.2022 Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit informon KPP-në se: *“[...] laborator i vetëm i akredituar prej saj për testimin e letrës dhe kartonit është Eko-Studio Projekt SHPK me adresë: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Nr.48, Tiranë”*.

Në mbështetje të shkresës së mësipërme, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi informacion shoqërisë *“Eko-Studio Projekt”* SHPK, nëse kjo e fundit ishte e profilizuar ose jo për të kryer vlerësimin teknik të parametrave të kërkuara më sipër për letrën A4, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit, si dhe informacion mbi koston apo tarifën, të cilat do të mbulohen nga ankimuesi.

Në datën 27.07.2022 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1293/9 prot., shkresa e shoqërisë *“Eko-Studio Projekt”* SHPK me nr. 567 prot., datë 25.07.2022 e cila deklaron se *ka në përbërje Laborator të Akredituar dhe të kompletuar me instrumente të standardeve bashkëkohore dhe efikase dhe kryen testim permanent dhe me kampione të komponentëve të [...] letrës dhe kartonit, si dhe bën me dije se për kryerjen e testeve dhe*

*fiksimin e rezultateve duhet të dërgohen në ambientet e laboratorit kampione përfaqësues në mjediset e laboratorit.*

Në datën 08.8.2022, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin nr. 757/2022, për kryerjen e ekspertizës për analizimin e gramaturës së mostrës të paraqitur nga operatori ekonomik, “Infosoft Office” SHPK sipas metodës/standardit të kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit nga laboratorit i akredituar i shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, nëse mostra e paraqitur është në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura nga operatori ekonomik “Infosoft Office” për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

Në datën 11.08.2022, në ambientet e Komisionit të Prokurimit Publik, u mbajt një seancë dëgjimore me përfaqësues të operatorëve ekonomikë “Interlogistic” SHPK, dhe “Infosoft Office” SHPK, përfaqësues të autoritetit kontraktor dhe KPP-së. Në prani të palëve të sipërcituara, në përgjigje të kërkesës së Komisionit të Prokurimit Publik për përzgjedhjen e mostrës që do t’i nënshtrohet testimit, nga ana e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK u deklarua që të dërgohet për testimin e gjithë rizma e dorëzuar si mostër dhe vetë laboratorit “Eko-Studio Projekt” të përzgjedhë fletën që do të analizojë/testojë. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua palëve prezente nëse kanë interes për të shoqëruar përfaqësuesin e KPP gjatë momentit të dorëzimit të mostrës në laboratorin e shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK. Nga palët prezente interes shfaqti vetëm përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankimues “Interlogistic” SHPK.

Me anë të shkresës nr.618 prot., datë 18.08.2022, protokolluar me tonën me nr.1293/12 prot., datë 22.08.2022, Laboratori “Eko – Studio – Projekt” SHPK ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik “Raport Testimi” të mostrave, nr. 618 Prot. datë 18.08.2022. Konkretisht, ndër të tjera në raportin e mësipërm theksohet:

*“[...] Përshkrimi: Analiza e letrës me kod SPS-PS-618 i cili u mor nga njëra prej letrave të rizmës të sjella për kampionim. Përzgjedhja u krye nga vetë anëtarët e komisionit. Nga kampioni u analizua një pjesë me sipërfaqes 15x 15 cm, e cila u peshua nga 5 herë në mënyrë të pavarur në të njëjtat kushte atmosferike. Rezultati i paraqitur më sipër është mesatarja e të gjitha peshimeve ..... Bazuar në formulën e sipërpërmendur masa mesatare e letrës është 75.903 g/m2.”*

Ndërsa me anë të shkresës nr. 647 prot., datë 07.09.2022 protokolluar me tonën me nr.1293/14 prot., datë 09.09.2022, “Eko – Studio – Projekt” SHPK ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik “Raport-Testimi” të mostrave të plotësuar nr. 618/1 Prot. datë 07.09.2022, ku përcaktohet se sasi e mostrës është *1 rizëm*. Konkretisht, ndër të tjera në raportin e mësipërm theksohet: *“[...] Per sa eshte thene me siper rezulton se vlera totale e nje rizme me 500 flete pa paketimin mbështjellës është shuma e Mostres II dhe Mostra IV qe ne total rezulton 2382,58 g ose 2,38258 kg ndersa vlera totale e rizmes bashke me paketimin mbeshtjelles eshte 2405.74 g ose 2.40574 kg.”*

III.1.10. KPP referuar Raportit të Testimit të mostrave, të dorëzuar në datë 22.08.2022 dhe 09.09.2022 nga Laboratori “Eko – Studio – Projekt” SHPK, si një laborator i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për testimin e mostrave të sipërpërmendura, konstaton, se mostra e paraqitur për testim nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, nuk është në përputhje me specifikimet teknike, pasi masa mesatare e një fijeje letre A4 sipas raportit të testimit të laboratorit “Eko – Studio – Projekt” SHPK është 75.903 g/m2, ndërkohë në specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor pesha e një flete A4 duhet të jetë *jo me pak se 78 gr/m2*. Gjithashtu, KPP vëren, se pas plotësimit të raportit të testimit të dërguar nga laboratorit Eko-Studio-Projekt me nr. 618/1 prot., datë 07.09.2022 rezulton, se

pesha e rizmës për të cilën në dokumentet e tenderit e konkretisht në specifikimet teknike autoriteti kontraktor nuk ka përcaktuar ndonjë standard europian apo ndërkombëtar të caktuar për testim është 2405.74 g ose 2.40574 kg, ndërkohë në specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor pesha e rizmës me 500 fletë duhet të jetë jo më pak se 2500 gr.

Në përfundim, sa më sipër analizuar, nga verifikimi i dokumentacionit dhe Raporteve të Testimit të mostrës (nr.618 prot., datë 18.08.2022 dhe nr. 618/1 prot., datë 07.09.2022) të Laboratorit të akredituar “Eko – Studio – Projekt” SHPK, konstatohet, se mostra për letrën A4, nuk është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Në këto kushte KPP gjykon, se mostra referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të siguruar produktin e kërkuar nga autoriteti kontraktor në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit dhe në rastin konkret sipas treguesve të raporteve të testimit të kryer nga laboratorit “Eko-Studio-Projekt” SHPK rezulton, se për peshën e letrës A4 (për 1 (një) fletë dhe për 1 (një) rizëm), operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK me mostrën e dorëzuar nuk përmbush specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Interlogistic” SHPK, qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues “Interlogistic” SHPK, mbi kualifikimin e padrejtë të operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, gjykojmë, se referuar arsytimit të mësipërm, gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë dhe duke përmbushur kështu interesin e ankimuesit. Rrjedhimisht pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues, nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2018, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-26060-04-21-2022, me objekt “Blerje kancelari për nevojat OSHEE Group Sh.A, për një vit”, me fond limit

59,423,158.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23.05.2022 nga autoriteti kontraktor Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group Sh.A.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
  3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
  4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK.
  5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**